



Hulumtim

*(Mos)përfshirja e
qytetarëve në
buxhetin komunal
Komuna e Vitisë*





Autorët: Lirim Xhimi & Adnan Ramadani

E drejta e autorit © 2023. POLITEIA.

Politeia i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga i ka marrë ato citate dhe materiale,

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Tel: +383 45 294 398

E-mail: organizata.politeia@gmail.com



Përmbajtja

Hyrje	5
Dëgjimet Buxhetore.....	6
Pjesëmarrja në Dëgjimet Buxhetore	7
Kërkesat në Dëgjimet Buxhetore	8
Ndarja e kërkesave nëpër drejtori	9
Drejtoria e Shërbimeve Publike	10
Drejtoria e Arsimit.....	11
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	12
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	13
Drejtoria e Bujqësisë	14
Rekomandime	15





Hyrje

Nocionet si Transparenca dhe Llogaridhënia, janë ndër nocionet kyqe për një qeverisje demokratike. Pushtetet lokale me qëllim të involvimit dhe krijimit të një buxheti sa më gjithëpërfshires, organizojnë disa takime publike direkte me qytetar që njihen si Dëgjime Buxhetore. Këto dëgjime kanë për qëllim konsultimin e qytetarëve me kërkesat dhe nevojat e tyre për t'i përfshirë kërkesat e tyre në buxhetin final.

Qëllimi i projekti *“Bëhu pjesë e buxhetit komunal”*, është përgaditja dhe ngritja e kapaciteteve të OSHC-ve lokale; Grupeve jofomale; Komunitetit të të Rinjëve; Klubeve të Sportit dhe Kryesuesve të këshillave të fshatrve të Komunës së Vitisë në përfshirjen e procesit të dëgjimeve buxhetore vjetore, me qëllim të ndikimit dhe përfshirjes së nevojave dhe kërkesave të këtyre grupeve në buxhetin vjetor komunal.


Hulumtimi *“(Mos)përfshirja e qytetarëve në buxhetin komunal”*, është realizuar në kuadër të fazës së katër të projektit *“Bëhu pjesë e buxhetit komunal”*. Ky hulumtim tregon të dhëna statistikore mbi kërkesat e qytetarëve të komunës së Vitisë në kuadër të dëgjimeve buxhetore të organizuara nga komuna e Vitisë për vitin 2024.

Në pjesët e mëposhtme gjeni të analizuar kërkesat e realizuar nga qytetarët të grafikuara në numër dhe përqindje për secilen fushë në të cilën janë realizuar. Të paraqitura në mënyrë statistikore të dhënat paraqesin përfillshmërin apo refuzimin e tyre nga ana e Komunës së Vitisë.



Dëgjimet Buxhetore


Komuna e Vitisë këtë vitë ka organizuar 5 dëgjime buxhetore, në të cilat ka pasur targete të ndryshme sic janë: Qyteti i Vitisë me fshatrat për-rreth, Grupet e Interesit, Fshati Skifteraj, Fshati Pozheran dhe Diskutimi i kryesuesit të Kuvendit me qytetar. Në këto dëgjime kanë marrë pjesë 110 pjesëmarrës dhe nga këto dëgjime buxhetore janë bërë 37 kërkesa drejtuar nivelit komunal për t'i përfshirë në buxhetin e vitit 2024.





Pjesëmarrja në Dëgjimet Buxhetore

Në dëgjimet buxhetore kanë marrë pjesë 110 pjesëmarrës. Në të kanë marrë pjesë 59 gra apo 54% dhe kanë marrë pjesë 51 burra apo 46%.






Kërkesat në Dëgjimet Buxhetore

Në dëgjimet buxhetore janë bërë 37 kërkesa nga qytetarët e Komunës së Vitisë. Nga këto kërkesa në buxhetin e vitit 2024 nga Komuna janë përfshi 13 kërkesa apo 35%, ndërsa 24 kërkesa apo 65% nuk janë përfshi në buxhetin e vitit 2024.


Kërkesat e qytetarëve në dëgjimet buxhetore





Ndarja e kërkesave nëpër drejtori

37 është numri i kërkesave nga qytetarët e Komunës së Vitisë në këto dëgjime buxhetore. Kërkesa më së shumti janë adresuar ndaj Drejtorisë së Shërbimeve Publike me 18 kërkesa apo 49%, pastaj vazhdon Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me 7 kërkesa apo 19%, Drejtoria e Arsimit me 6 kërkesa apo 16%, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me 3 kërkesa apo 8% dhe në fund Drejtoria e Bujqësisë me 3 kërkesa apo 8%.






Drejtoria e Shërbimeve Publike

Drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike janë bërë 18 kërkesa nga ana e qytetarëve të Komunës së Vitisë, nga to janë përfshi 8 kërkesa apo 44% ndërsa nuk janë përfshi 10 kërkesa apo 56%.

Përfshirja e kërkesave nga Drejtoria e Shërbimeve Publike






Drejtoria e Arsimit

Ndaj Drejtorisë së Arsimit nga qytetarët janë bërë 6 kërkesa, nga to janë përfshi 1 kërkesë apo 17%, ndërsa nuk janë përfshi 5 kërkesa apo 83%.

Përfshirja e kërkesave nga Drejtoria e Arsimit






Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i janë dorëzuar 7 kërkesa, nga to janë përfshi 2 kërkesa apo 29%, ndërsa nuk janë përfshi 5 kërkesa apo 71%.

Përfshirja e kërkesave nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale






Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Qytetarët e Vitisë i kanë bërë 3 kërkesa ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nga to janë përfshi 1 kërkesa apo 33%, ndërsa nuk janë përfshi 2 kërkesa apo 67%.

Përfshirja e kërkesave nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit






Drejtoria e Bujqësisë

Ndaj Drejtorisë së Bujqësisë janë bërë 3 kërkesa nga qytetarët e Vitisë, nga to janë përfshi 1 kërkesë apo 33% ndërsa nuk janë përfshirë 2 kërkesa apo 67% në buxhetin e vitit 2024.

Përfshirja e kërkesave nga Drejtoria e Bujqësisë





Rekomandime


Si rezultat i këtij hulumtimi mund të vijmë në një përfundim se aprovimi apo përfillshmëria e kërkesave të qytetarëve të Komunës së Vitisë në dëgjimet buxhetore të vitin 2024 nuk është e kënaqshme dhe për pasojë ndikon negativisht në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës nga ana e Pushteti Lokal karshi qytetarëve.

Organizata POLITEIA, përgjatë gjithë kohës ka monitoruar të gjitha dëgjimet buxhetore të vitit 2024 në Komunën e Vitisë, dhe në të njëjtën kohë apelon tek Komuna e Vitisë që t'i marr parasysh këto rekomandime, me qëllim të forcimit të bashkëpjesëmarrjes dhe rritjes së përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe buxhetim të përbashkët.

- Përfshirje më e madhe e kërkesave në buxhet nga fusha e shëndetësisë lokale;
- Përfshirje më e madhe e kërkesave në buxhet nga fusha e Bujqësisë (krijimi i nje fondi rezerv për dëmet atmosferike);
- Përfshirje më e madhe e kërkesave në buxhet për rritjen e shumës dhe numrit së bursës për student;
- Përfshirje më e madhe e kërkesave në buxhet për të rinjët;
- Përfshirje më e madhe e kërkesave në buxhet për personat me nevoja të vecanta
- Përfshirje më e madhe e kërkesave në buxhet për rregullimin dhe furnizimin me ujë të pijeshem;



Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e OJQ Politeia dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së apo Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC
Büro für Entwicklung und
Zusammenarbeit SDC

